

# **PËR NDRYSHIM TË EMËRTIMIT TË SHOQËRISË DHE I DREJTUESVE LIGJOR APO SELISË TË SHOQËRISË**

## **DOKUMENTET PËR APLIKIM**

- a) Kërkesë me shkrim nga përfaqësuesi ligjor për këtë ndryshim;
- b) Ekstrakti historik i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bizneseve, që vërteton ndryshimet (të lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi);
- c) Vetëdeklarim të drejtuesit/ve ligjor/ë të rinj, ku ata të deklarojnë se njohin dhe angazhohen të zbatojnë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojnë se nuk janë të dënuar nga organet e gjyqësorit, në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit;
- ç) Vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen nga shoqëria të të gjitha detyrimeve tatimore vërtetim, të lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi (vërtetim nga drejtoria rajonale tatimore dhe nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore pranë bashkisë respektive).

+ pagesa e tarifës

## **Dorëzimi, pranimi i aplikimit**

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
2. Dokumentet për licencë duhet të jenë:
  - a) origjinale ose fotokopje të noterizuara;
  - b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;
  - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili shkarkohet nga portali ose mund të disponohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë së Zhvillimit Urban.

## **Kushte paraprake**

1. Shoqëria dhe vlerësuesit e shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të plotësojë kushtin që të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore për çështje që kanë lidhje me ushtrimin e aktivitetit profesional si vlerësues dhe të mos jetë në periudhën e ekzekutimit të një mase administrative të mëparshme, kundrejt licencës profesionale për vlerësim.
2. Vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të njohë dhe të angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e këtij profesioni dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit.
3. Shoqëria, që kërkon të licencohet, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore.
4. Shoqëria duhet të ketë statusin "aktiv" të ushtrimit të veprimtarisë në QKB dhe të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi.

VKM nr. 712, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme"